

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Prishtinës z. Isa Mustafa**

I nderuari z. Mustafa,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumentuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në “Jeta në Kosovë”, ju keni premtuar:

- Prishtina – Qendër metropolitane, që nënkupton zhvillim dhe integrim me komunitat tjera, bashkëpunim ekonomik, urban, arsimor e kulturor;
- Shuma e përgjithshme e investimeve kapitale gjatë katër viteve të ardhshme do të arrijë në vlerë prej 700 milion euro;
- Kushte për zhvillimin e bizneseve për të krijuar vende pune për të rinj dhe femra;
- Shërbime efikase për biznese, zona industriale, parqe dhe inkubatorë të biznesit;
- Zhvillimin e Zonës Ekonomike të Prishtinës;
- Përkrahjen për bujqit për ngritje të serrave dhe ndërtim të minifermave;
- Investime në pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe në mirëmbajtjen dhe ruajtjen e lumenjve nga keqpërdorimi dhe shfrytëzimi joefikas;
- Eliminimin e ndërrimit të tretë dhe të katërt në shkolla fillore (deri në vitin 2011);
- Aplikimin e teknologjisë informatike: rrjeti kompjuterik dhe qasja në internet;
- Salla të edukatës fizike në çdo shkollë;
- Shkolla të mesme dhe profesionale në përputhje me kërkesat e tregut;
- Shkolla të reja moderne në rrjet adekuat dhe me infrastrukturë përcjellëse: laboratorë, salla sportive, rrjet kompjuterik dhe internet;
- Përfshirjen e sektorit privat, sektorit publik dhe agjencive ndërkombëtare dhe donatorëve në artikullimin e plan-programeve mësimore;
- Partneritetin i ngushtë me Universitetin e Prishtinës, me universitetet/kolegjet private dhe institucionet shkencore;
- Për studentë vendorë dhe të huaj: kushte më të mira të jetesës në Prishtinë;
- Promovimin e studio-banesave si alternativë shtesë e banimit për studentë, si projekte në partneritet publiko-privat;
- Përfundimin e Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Zhvillimor Komunal dhe hartimi i të gjitha planeve rregulluese të qytetit të Prishtinës (deri në vitin 2011);
- Eliminimin e burimeve për informalitete në fushën e ndërtimeve dhe legalizimi i objekteve të ndërtuara pa leje duke pasur parasysh kriteret e bazuara në aspektin e sigurisë (rrugët e evakuimit, mbrojtja nga zjarri, statika dhe dinamika e ndërtesave), aspektin social (raportet ndërfaqinësore-vizurat, insulimi, uzurpimet), dhe infrastrukturë teknike dhe sociale;
- Ndërtimin e mekanizmave për menaxhim urban efikas;
- Ndërtimin dhe regjenerimin e qendrës së Prishtinës në vitin 2010 (Sheshi Ibrahim Rugova, Sheshi Skënderbeu dhe Sheshi Zahir Pajaziti);
- Rregullimin e zonave urbane që kanë lidhje qasëse me këtë qendër;

- Hartimin e Planit të Konzervimit për zonën historike dhe lidhja e forte e kësaj zone me qendrën e vjetër të qytetit;
- Ndërtimin e qendrës së banimit dhe biznesit në lagjen Dodona që ka qasje në rr. Agim Ramadani (përballë Kuvendit të Kosovës) në partneritet publiko-privat;
- Planifikimin urbano-arkitektonik i Qendrës së Re në kuadër të Prishtinës së Re, ndërmjet Pallatit Presidential dhe institucioneve qeveritare;
- Projektimin e Sheshit Presidential (Prishtina e Re – zona qendër) dhe Sheshi i Miqësisë (Rr. “B”- Lagja e Spitalit);
- Parqe të reja në Kodrën e Trimave, në Fushën e Pajtimit, në qendër të qytetit dhe te Fabrika e Tjegullave (së bashku me rregullimin e dheut rrëshqitës);
- Sipërfaqe të reja gjelbëruese në Qendër të qytetit, në Zonën Historike (Qendra e Pionierëve), në Lagjen Çamëria (Fusha e Pajtimit), në Arbëri (regjenerimi dhe zgjerimi i parkut);
- Përkrahje për rregullimin dhe gjelbërimin e hapësirave të Universitetit të Prishtinës;
- Vazhdimin e rregullimit të shtigjeve dhe gjelbërimit të varrezave të qytetit;
- Pajisjen e parqeve, hapësirave publike dhe bulevardëve me vende të uljes dhe me infrastrukturë të duhur mikrourbane;
- Ngritjen e fontanave të përmasave dhe dizajnëve të ndryshme në parqet e qytetit dhe në sheshe, duke filluar me qendrën e qytetit;
- Krijimin e krojeve në hapësirat publike ku kjo do të jetë e mundshme dhe veçanërisht në sheshet para objekteve publike;
- Vlerësimin e ringjalljes në fragmente të dy lumenjve të mbuluar të Prishtinës si pjesë e projekteve kapitale të rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe të ujërave atmosferike në qytet;
- Mbrojtjen e parkut të Gërmisë si Zonë e Veçantë dhe hartimin e Planit, nëpërmjet të cilit do të vendosen kornizat e rregullimit dhe të aktiviteteve në këtë park; (Ofrimin e mundësive për ecje, vrapim dhe aktivitete tjera që ndërlidhen me rekreimin në natyrë; Inkurajimin e turizmit rural nëpërmjet përkrahjes së sporteve formale dhe joformale të formave të ndryshme);
- Ndërtimin e rrugëve dhe heqja definitive e baltës nga qyteti;
- Rigjenerimin dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore në të gjitha pjesët rurale të Komunës;
- Përfundimin e Rrugës Unazore Qendër;
- Ndërtimin e Rrugës Unazore të Parë në faza, sipas prioriteteve të zhvillimit të qytetit dhe orientimi i trafikut nëpërmjet kësaj rruge unazore;
- Nënkalime dhe mbikalime për këmbësorë;
- Rrjet të organizuar të parkingjeve në gjithë qytetin dhe garazhe parkuese;
- Shfrytëzimin e hekurudhës nga Fushë Kosova deri në fshatin Bardhosh si linjë e trafikut urban dhe suburban;
- Reformimin e plotë dhe rritjen e efikasitetit të shërbimit të taksive;
- Kufizimin e hyrjes së automjeteve në zonën e parë të qytetit (brenda unazës qendër);
- Kompletimin e rrjetit të shëndetit parësor;
- Sistem informatikë në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF);
- Pajisje dhe modernizim i QMF-ve me aparaturë të nevojshme mjekësore;
- Përcaktimin e mjekut familjar sipas zonave;
- Furnizimin e rregullt i QMF-ve me barna;
- Ambulanca mobile për pensionistët dhe personat që nuk mund të vizitohen në QMF;
- Përkujdesje të veçantë shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara;
- Ngritjen e Spitalit të Qytetit, dhe në zonën përreth, ofrimi i mundësive për ngritjen e klinikave specialiste;
- Partneritet me QKUK-në në funksion të regjenerimit të hapësirës brenda dhe jashtë lokacionit të QKUK;

- Banim social për personat dhe familjet e pastreha;
- Banim social për familje të luftëtarëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve të UÇK-së;
- Përkujdesje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara –integrimi i tyre në shoqëri;
- Lirim nga tatimi në pronë për familjet në asistencë sociale;
- Përkrahje për klubet, shoqatat dhe format e ndryshme të organizimit të të rriturve dhe të rinjve nga fusha e kulturës;
- Pasurimin e bibliotekave ekzistuese me literaturë të re dhe teknologji informatike dhe promovimin e leximoreve dhe bibliotekave në kuadër të objekteve arsimore, në objekte të reja shumë funksionale dhe me qasje publike;
- Fond të veçantë për zhvillimin e rrjetit bibliotekar në komunë;
- Promovimin e artit publik: caktimin e hapësirave për ekspozim në ambiente të hapura, në sheshet pranë objekteve publike, në sheshet dhe bulevardet primare të qytetit dhe në hapësirat e lira;
- Krijimin e zonave të lira të internetit, duke filluar me Parkun e Qytetit;
- Ndërtimin e objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive;
- Ngritjen e fushë lojërave për të rinj në çdo lagje, në hapësira të lira publike dhe në kuadër të parqeve;
- Ndërtimin e kompleksit të fushave sportive në “Fushën e Pajtitit”;
- Ngritjen e Qendrës Rekreative Sportive në Zonën Ekonomike me partneritet publik privat;
- Restaurimin dhe konservimin e pjesëve të vjetra të qytetit, hapësirave pranë objekteve fetare dhe me rëndësi historike;
- Ndërtimin e aneksit të Pallatit të Rinisë me partneritet publik privat;
- Kthimin e Pallatit të Rinisë në qeverisje të komunës dhe rekonstruktimi i tij nëpërmjet partneritetit me Komisionin Evropian dhe Qeverinë e Kosovës;
- Çerdhe dhe kopshte të reja për fëmijë në çdo lagje të Prishtinës, në partneritet publik privat;
- Kënde të lojës për fëmijë në çdo lagje, në kuadër të parqeve dhe në hapësira të lira publike në qytet;
- Rekonstruimin e rrjetit të ujit dhe ndërtimin e fabrikës së ujit në Shkabaj;
- Ngritjen e fabrikës për pastrimin e ujërave të zeza, në partneritet me komunën e Podujevës, Kastriotit dhe Fushë Kosovës;
- Ndërtimin e magjistraleve të kanalizimit përgjatë shtratit të lumit Llap dhe Kanalit Ibër Lepenc për të kolektuar rrjetet e kanalizimit të fshatrave përreth;
- Vazhdimin e projekteve të kanalizimit në fshatrat në afërsi të Prishtinës;
- Përkrahjen e projekteve të NP “Termokos” për rigjenerimin dhe zgjerimin e kapaciteteve të ngrohjes qendrore për nevoja të ndërtimeve ekzistuese dhe ndërtimeve të reja;
- Promovimin e burimeve alternative dhe më të lira të ngrohjes nëpërmjet energjisë gjeotermale dhe energjisë alternative diellore;
- Trajtimin dhe mirëmbajtjen e hyrjeve dhe ashensorëve në objekte banesore;
- Riorganizimin e NP “Pastrimi” dhe kyçjen e konkurrencës private për të ngritur rregullsinë e mbledhjes së mbeturinave dhe nivelin e pastrimit dhe larjes së rrugëve;
- Zhvillimin e projekteve për riciklim të mbeturinave dhe prodhim të energjisë elektrike nga mbeturinat;
- Reformë të stafit administrativ: pranim të punonjësve të moshës së re dhe të përgatitur profesionalisht;
- Organizimin bashkëkohor të punës me palë në sportele të hapura dhe digjitalizimin e plotë të lëshimit të dokumentacionit (shërbimet e ofiçarisë dhe dokumentet tjera për qytetarë dhe biznese);
- Riorganizimin e inspektionit në përputhje me nevojat e Prishtinës dhe përgjegjësitë specifike të drejtorive;

- Ndërtimin e nga një fushe sportive në çdo lagje të qytetit;
- Subvencionimin e bujqve të Barilevës në aktivitetet e tyre të bujqësisë, pemëtarisë dhe perimtarisë;
- Ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë duke filluar nga viti 2011;
- Nënkalimin që lidh lagje; “Dardania” dhe “Pejton” do të realizohet në 2010, pas përfundimit të rrethrotullimit që ka filluar MTPT në hyrje të qytetit nga Fushë Kosova;
- Ndërtimin e Prishtinës së Re me baza bashkëkohore të ndërtimit;
- Përfundimin e asfaltimit të të gjitha rrugëve dhe rrugicave të Prishtinës në dy vitet e ardhshme;
- Sigurimin e ujit të pijshëm 24 orë për katër vitet e ardhshme;
- Rregullimin e ashensorëve;
- Investime në fshatin Keqekollë: investime në rrugë, turizëm, zhvillim ekonomik, rritje të punësimit; shërbime të digjitalizuara administrative ku banorët e kësaj ane nuk do të kenë nevojë që të shkojnë në Komunë por do të marrin dokumentet e tyre me postë;
- Ndërtimin e rrjetit të shkollave të mesme në periferi të qytetit, kurse shkollat aktuale në brendi të qytetit të shndërrohen në shkolla fillore;
- Ulje të tarifave për zejtarët;
- Krijimin e dy qendrave kryesore në qytetin e Prishtinës
- Dhënien e shumë projekteve me koncesion dhe partneritet publiko – privat ( 30 milionë euro si huazim, të cilat me ligj do tu lejohen komunave. Nga ligji për Prishtinën do të arkëtohen 40 milionë euro, nga buxheti komunal 180 milionë dhe nga donacionet rreth 100 milionë euro.).

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)